



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE

R R E G U L L O R E

Nr. 6 Datë 23.12.2008

PËR
DHËNIEN E
“ÇERTIFIKATËS OPERATORIT RADIODETAR”

Miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP Nr. 522, Datë 23.12.2008
Ndryshuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP Nr.2254, Datë 23.01.2013

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i rregullores është dhënia nga Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) e Çertifikatës së Operatorit Radiodetar në përputhje me formatin, standardet dhe rekomandimet ndërkombëtare të fushës të pranuar nga Republika e Shqipërisë.

Neni 2

Objekti

Objekti i rregullores është publikimi i kriterëve dhe procedurës që zbaton AKEP për dhënien e Çertifikatës së Operatorit Radiodetar dhe rregullave për testimin e përdoruesve të stacionit radio të anijes dhe radiobregdetar.

Neni 3

Baza ligjore

1. AKEP, nxjerr këtë rregullore në mbështetje të:
 - a) Gërmës p) dhe t) të nenit 8 të ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (ligji nr. 9918), i ndryshuar;
 - b) Pikës III “Çertifikimi i operatorit radiodetar” të Vendimit të Keshillit të Ministrave nr. 370, datë 05.06.2003 “Për shërbimin e Radiondërlidhjes detare në Republikën e Shqipërisë” (VKM nr. 370).
2. Dispozitat e rregullores bazohen ne:
 - a) Radiorregulloren e ITU, rezoluta 343 (WRC – 97) dhe Konventes SOLAS (Safety of Life at Sea);
 - b) Konventën Ndërkombëtare të IMO mbi Standartet e përgatitjes, Çertifikimit dhe Vëzhgimit për Detarët, 1978, e shtuar me 1995 (STCW 95), referuar pjesës A dhe pjesës B të Kapitullit VIII.

Neni 4

Detyrimi për çertifikim

1. Përdoruesi i stacionit radioanije (për anijet mbi 300 GRT – Gross Registered Tonnage) dhe stacionit radiobregdetar, duhet të pajiset me çertifikatën e operatorit radiodetar nga AKEP.
2. Bazuar në Konvetën SOLAS - Rregulli 16 (Radio Personnel), çdo anije mbi 300 GRT, për përdorimin e stacioneve radio duhet të ketë personel të kualifikuar Radiooficer dhe/ose dy operatorë radiodetar, të çertifikuar nga AKEP.

Neni 5

Kriteret e marrjes së Çertifikatës të Operatorit Radiodetar

1. Të jetë shtetas i Republikës së Shqipërisë.
2. Të jetë në moshën mbi 18 vjeç.
3. Të ketë mbaruar arsimin e mesëm ose të lartë.

4. Të ketë mbaruar Shkollën e Lartë të Marines/Navale ose kursin e plotë të trajnimit GMDSS (Global Maritime Distress & Safety System) në përputhje me STCW 95.
5. Çertifikatat për operatorët radiodetar të lëshuara në vendet e tjera (të listës së bardhë – white list të IMO) në përputhje me Artikullin 47.9 – 47.16 të Radiorregullores së ITU dhe STCW 95, AKEP i konsideron të vlefshme në Republikën e Shqipërisë.

Neni 6 **Formulari i aplikimit**

1. Personi që kërkon të pajiset me çertifikatën e operatorit radiodetar duhet të aplikojë online sipas formularit të aplikimit të përcaktuar në Aneksin 1 të kësaj rregulloreje, i cili duhet të shoqërohet me deklaratën personale të personit dhe dy copë fotografi (4x6 cm).
2. Formulari i aplikimit online plotësohet tek Moduli i Aplikimit Online për “Çertifikatë të operatorit radiodetar” në faqen web të AKEP www.akep.al

Neni 7 **Dhënia e Çertifikatës**

1. Çertifikata i jepet aplikuesit brenda 7 (shtatë) ditëve nga data që ka depozituar në AKEP formularin e aplikimit online të plotësuar në përputhje të plotë me kërkesat e përcaktuara në këtë rregullore dhe pasi të ketë kryer pagesën përkatëse për marrjen e çertifikatës.
2. Kur AKEP konstaton parregullsi në plotësimin e formularit të aplikimit të dërguar online, i kërkon aplikuesit rregullimin e tyre brenda një periudhe prej 5 (pesë) ditësh pas marrjes së njoftimit online për parregullsitë e konstatuara.
3. Trajtimi i kërkesës online bëhet nga Drejtoria përkatëse në AKEP dhe Çertifikata lëshohet e nënshkruar nga Kryetari.
4. Format i Çertifikatës është sipas Aneksit 2 të kësaj rregulloreje në përputhje me Artikullin 47.9 – 47.16 të Radiorregullores së ITU.
5. Në rastet kur është e nevojshme, çertifikata e lëshuar shoqërohet me një vërtetim (endorsement) të saj, sipas radiorregullores WRC 97 të ITU dhe konventes STCW 95 të IMO.
6. Formulari i aplikimit online nënshkruhet nga subjekti në momentin e tërheqjes Çertifikatës dhe i bashkëngjitet praktikës që arkivohet në AKEP.

Neni 8 **Vlefshmëria e çertifikatës dhe rinovimi**

1. Çertifikata e operatorit radiodetar është e vlefshme për një periudhe 3 vjeçare nga data e hyrjes në fuqi të saj, me të drejtë rinovimi.
2. Për rinovimin e çertifikatës, aplikanti i drejtohet AKEP duke dërguar online kërkesën 15 ditë para përfundimit të vlefshmërisë së saj.

Neni 9

Detyrimet Financiare

1. Aplikuesi, me marrjen e njoftimit online nga AKEP për miratimin e licenses së kërkuar, është i detyruar që të paguajë detyrimet financiare të parashikuara për licencën në përputhje dhe zbatim të legjislacionit në fuqi, akteve nënligjore dhe rregullave të përcaktuara nga AKEP.
2. Mënyra, niveli dhe afati i pagesave në reference me pikën 1 të këtij neni, publikohen nga AKEP dhe i bashkëngjiten kësaj rregulloreje në formë aneksi.

Neni 10 Regjistrimi

1. AKEP, regjistron të certifikuarit në një regjistër i cili publikohet në faqen e internetit dhe përmban këto të dhëna:
 - a) Të dhënat mbi certifikaten (nr., data, vlefshmëria, etj);
 - b) Mbajtësin e certifikatës (emri, mbiemri);

Neni 11 Testimi i operatorëve radiodetar

Procedurat e testimit sigurojnë që përdoruesit e stacioneve radio zotërojnë njohuritë e nevojshme për përdorimin e pajisjeve të tyre dhe të kenë njohuri për procedurat e thirrjeve në pergjithësi, dhe në veçanti për procedurat e përdorura në raste fatkeqësie dhe shpëtimi, të përcaktuara në rregulloren ndërkombëtare të ITU dhe STCW 95 të IMO.

Neni 12 Aplikimi për testim

1. Për marrjen e Çertifikatës së Operatorit Radiodetar aplikanti duhet t'i nënshtrohet procedurës së testimit në AKEP në përputhje me këto kërkesa:
 - a) paraqitja e kërkesës online shoqëruar me dokumentet e kërkuara,
 - b) të jetë në moshën mbi 18 vjeç,
 - c) dokumentin e identifikimit sipas legjislacionit në fuqi,
 - d) dokumentin e përfundimit të arsimit të mesëm ose të lartë,
 - e) dy copë fotografi (4x6 cm),
 - f) konfirmimin e kryerjes së pagesës për testimin, sipas rregullave.

Neni 13 Komisioni i testimit

1. Për realizimin e testimit ngrihet një komision prej 5 anëtarësh me përbërje si më poshtë:
 - a) 3 (tre) përfaqësues të AKEP;
 - b) 1 (një) përfaqësues të Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit;
 - c) 1 (një) përfaqësues të Kapitenerisë së Përgjithshme të Porteve,
2. AKEP, nëse e gjykon të nevojshme, brenda numrit të saj të përfaqësimit mund të thërrasë ekspertë të jashtëm të fushës.

Neni 14

Testimi

1. Nëse ka kërkesa, provimi për testimin e operatorëve radiodetar zhvillohet 1 (një) herë në vit.
2. Data e provimit dhe kriteret e veçanta përcaktohen nga AKEP, rast pas rasti.
3. Testimi do të kryhet për vlerësimin e njohurive në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Aneksin 3, të kësaj rregullore.
4. Aplikanti fitues pajiset me Çertifikatën e Radio Operatorit.

Neni 15

Dispozita të tjera

1. Kjo Rregullore hyn në fuqi datën e miratimit të saj nga KD i AKEP.
2. Çdo ndryshim i mundshëm i Rregullores do të bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi në Republikën e Shqipërisë dhe vendimet dhe rekomandimet e ITU të pranuar nga Republika e Shqipërisë.

Miratuar me Vendim Nr. 522, Datë 23.12.2008 të Këshillit Drejtues të AKEP,
ndryshuar me Vendim Nr. 2254, datë 23.01.2013, të Këshillit Drejtues të AKEP.

**FORMULAR APLIKIMI ONLINE
PËR
PAJISJEN ME CERTIFIKATË TË OPERATORIT RADIODETAR**

1. Të dhënat e aplikantit:

1.1	Aplikanti	Emri:	Mbiemri:	Datëlindja:		
1.2	Adresa Postare					
1.3	Telefon/Faks					
1.4	E-mail					
1.5	Numri Personal sipas Dokumentit të Identifikimit - ID	Nr:	Datë:			
1.6	Pasaporta e Detarit	Nr:	Datë:		Detyra:	
1.7	Diploma e Shkollës së Lartë të Marinës/Navale ose Deshmia e Kursit të Trajnimit GMDSS sipas STCW 95	Nr:	Datë:			
1.8	Deftesa e përfundimit të shkollës së mesme ose të lartë	Nr:	Datë:			
1.9	Certifikata e Kompetencës nga Kapiteneria Detare	Nr:	Datë:	Funksioni:	Niveli:	Kapaciteti i anijes (GRT):
1.10	Aplikuesi kërkon Vërtetim (Endorsement)	Po:	Jo:			

Shënim: Ky formular shoqërohet me 2 (dy) copë fotografi (4x6 cm).

DEKLARATË E APLIKUESIT

Nën përgjegjësi time të plotë ligjore, deklaroj se të dhënat, dëshmitë dhe informacioni i paraqitur në formularin e aplikimit online dhe çdo lidhje të tij janë të vërteta, të sakta dhe në përputhje me çdo kërkesë të parashikuar ligjërisht mbi përgjegjësinë e vetëdeklarimit.

Me marrjen e Certifikates deklaroj se do të zbatoj :

1. Ligjin nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar dhe aktet nën ligjore të fushës;
2. Kërkesat e rekomandimeve përkatëse të ITU dhe IMO;
3. Kërkesat e rregullores për dhënien e Çertifikatës së Operatorit Radiodetar.

(data)

(emri, mbiemri)

(firma)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
 AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE

ÇERTIFIKATË

aftësie e RADIO OPERATORIT GMDSS
 lëshuar sipas dispozitave të Konventës Ndërkombëtare
 mbi Standardet e Përgatitjes, Certifikimit dhe Vëzhgimit
 për Detaret, 1978, e ndryshuar më 1995, përfshirë dhe Kërkesat Kombëtare

Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare të Shqipërisë vërteton se Çertifikata Nr. ___/___, i është lëshuar Z. _____, i cili ka kualifikimin e duhur në përputhje me dispozitat e rregullores A-IV/2 (B-IV/2) të Konventës së sipërpërmendur, me ndryshimet, dhe është i aftë të kryejë funksionet që vijojnë, në nivelet e përcaktuara, subjekt i cdo kufizimi të shënuar më poshtë:

DETYRA	NIVELI	KUFIZIME
		E vlefshme si ÇERTIFIKATË E OPERATORIT TË PËRGJITHSHËM

Mbajtësi i ligjshëm i kësaj Çertifikate mund të kryejë shërbime në kapacitetin ose kapacitetet e përcaktuara në kërkesat e zbatueshme te Administratës për sigurinë e jetës në anije.

KAPACITETI	KUFIZIME
Mbi _____ GRT	E vlefshme si ÇERTIFIKATË OPERATORIT TË PËRGJITHSHËM

Çertifikata Nr. ___/___

Lëshuar më __ . __ . ____

Kjo Çertifikatë është e vlefshme deri më __ . __ . ____


KRYETARI

Orgjinali i kësaj certifikate duhet të ruhet në përputhje me rregulloren I/2, paragrafi 9 i Konventës, gjatë kohës së shërbimit në anije.

Datëlindja e mbajtësit të çertifikatës __ . __ . ____

Firma e mbajtësit të çertifikatës

Tiranë, SHQIPËRI, Data __ . __ . ____





REPUBLIC OF ALBANIA
ELECTRONIC AND POSTAL COMMUNICATIONS AUTHORITY

C E R T I F I C A T E

of competence for GMDSS RADIO OPERATOR
issued under the provisions of International Convention
on Standard of Training, Certification and Watchkeeping
for Seafarers, 1978, as amended in 1995, incl. National Requirements

Electronic and Postal Communications Authority of Albania certifies that Certificate No. __ .__. __ has been issued to *Mr.* _____, who has been found duly qualified in accordance with the provisions of regulation A-IV/2 (B-IV/2) of the above Convention, as amended, and has been found competent to perform the following function, at levels specified also, subject to any limitations as indicated.

FUNCTION	LEVEL	LIMITATION APPLYING
		Valid as GENERAL OPERATOR CERTIFICATE (GOC)

The lawful holder of this endorsement may serve in the following capacity or capacities specified in the applicable safe manning requirements of the Administration.

CAPACITY	LIMITATION APPLYING
Above _____ GRT	Valid as GENERAL OPERATOR CERTIFICATE

Certificate No. __ .__. __

Issued on: __ .__. __

This Certificate is valid until __ .__. __

Signature of duly authorized official

Name of duly authorized official

CHAIRMAN


The original of this certificate must be kept available in accordance with regulation I/2, paragraph 9 of the Convention while serving on a ship.

Date of birth of the holder of the certificate __ .__. __

Signature of Holder of certificate

Photograph of the holder of the certificate

Tirana, ALBANIA Date __ .__. __



KERKESAT E TESTIMIT

Testimi do të bazohet në referencat e mëposhtme të IMO (A.703/17) dhe ITU:

1. R1 – GMDSS Handbook,
2. R2 – MERSAR Manual,
3. R3 – Standard Marine Communication Phases,
4. R4 – Master Plan of the shore-based facilities for the GMDSS,
5. R5 – STCW Code,
6. R6 – Resolution A.814 (19),
7. R7 – Konventen SOLAS 1974, e amenduar,
8. ITU Text Books T1, T2 dhe T3.